




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr Prot. Bi Prot. 01-336/13
Nr. i faq. Broj stranica 02	Data Datum 14.10.2013
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **08.10.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2625/13, për ztr. *Ilir Azemi – Anëtar i Bordit të Ndërrmarrjes banesore në Prishtinë, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2625-13, për Zyrtarin e lartë, z. Ilir Azemi – Anëtar Bordi në Ndërrmarrjen publike banesore të Prishtinës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-2625/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Azemi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Azemi është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtrij funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë z.Azemi në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-3161/13), në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte të ndërmarrja N.t.sh.“Icount”, për të ushtruar vet funksionin e tij zyrtar si Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes banesore të Prishtinës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

